

OUCH!

NË KËTË EDICION..

- Përmbledhje
- Gjërat themelore
- Fëmijët e vegjël

Mbrojtja e zbrazëtirës kibernetike të gjeneratave

Përmbledhje

Shumica nga ne ndihemi mirë me teknologjinë, duke përfshirë edhe përdorimin e sigurt të saj. Por pjesa tjetër e familjes sonë mund të mos ndihet aq rehat me teknologjinë, sidomos nëse nuk janë rritur në praninë e kompjuterëve apo Internetit. Në vijim do të gjeni disa hapa si ju mund t'i ndihmoni për ta mbrojtur këtë zbrazëtirë të gjeneratave. Gjithashtu, ju mund të keni ndërmarrë disa hapa si t'i mbroni fëmijët kur janë në shtëpinë tuaj, por hapa të ngjajshëm mund edhe të mungojnë në një shtëpi të ndonjë të afërmi tuaj kur vizitohen nga fëmijët tuaj. Prandaj ne do të përfshijmë edhe disa këshilla se si të krijoni ambiente më të sigurta online edhe kur fëmijët tuaj vizitojnë hapësira tjera.

Botuesi i ftuar

Brian Honan (Twitter [@brianhonan](#)) është konsulent i pavarur i sigurisë dhe jeton në Dublin, Irlandë, dhe është themelues dhe udhëheqës i CERT-it të parë në Irlandë, këshilltar special i qendrës për krime kibernetike të Europolit (EC3), dhe ligjëron sigurinë e informacionit në Kolegjin Universitar të Dublinit. Ai është autor i disa librave dhe shkruan për publikime të ndryshme.

Gjërat themelore

Disa hapa të thjeshtë mund të bëjnë ndryshimin e madh në mbrojtjen e jetës sonë digjitale. Më poshtë gjeni disa hapa të thjeshtë, por themelore, që ne i rekomandojmë për cdo antar të familjes. Nëse ndonjëri nga antarët tuaj të familjes nuk i kupton këto hapa, ju duhet t'i ndihmoni t'i kuptojnë apo t'i ndërmerrni vetë.

- **Inxhinjria sociale:** Spjegojani me fjalë të thjeshta se çfarë domethënie ka inxhinjria sociale. Mashtrimet dhe mashtruesit kanë ekzistuar me mijëra vite, dhe këto lloj sulmesh nuk janë të reja. Dallimi i vetëm është se sot mashtruesit i aplikojnë të njejtat mënyra me anë të internetit. Jepni shembuj se si funksionojnë mashtrimet në ditët e sotme, si p.sh. emailt 'phishing' apo thirrjet mashtruese që duken gjasmë nga përkrahja teknike e Microsoftit. Nëse asgjë tjetër, ju duhet t'i bindni antarët e familjes suaj që kurrë mos t'i japin fjalëkalimin askujt apo të lejojnë ndokënd të qaset nga distanca në kompjuterin e tyre. Në fund, siguroni ata që nëse kanë ndonjë paqartësi apo nuk janë të sigurt si të veprojnë me ndonjë email apo ndonjë thirrje, t'ju thërrasin juve para se të japin ndonjë informatë.
- **Rrjeti Wi-Fi i shtëpisë:** Angazhohuni seriozisht që të siguroheni që rrjeti Wi-Fi në shtëpi është i siguar. Së paku sigurohuni që fjalëkalimi fillestar në pajisje është i ndërruar, ka fjalëkalim të fortë për të hyrë në rrjetin Wi-Fi, dhe rrjeti përdor lidhje që përdor enkriptimin më të sigurt të mundshëm. Ju mund të shkoni edhe një hap më tej, të rregulloni rrjetin Wi-Fi ashtu që të përdorë një formë më të sigurt të DNS, sikurse është www.opendns.org. Shërbimet e sigurta DNS si kjo jo vetëm që parandalojnë që përdoruesit e rrjetit

Mbrojtja e zbrazëtirës kibernetike të gjeneratave

të hyjnë në faqe të infektuara, por ju japin juve kontroll mbi faqet që njerëzit mundën apo nuk mund të vizitohen, gjë që mund të jetë shumë e dobishme për fëmijët vizitorë.

- **Arnimet e sigurisë (ang. Patching):** Përditësimi i sistemeve dhe mbajtja e tyre me arnimet e fundit të sigurisë është një veprim themelor që ju mund të ndërmerrni për të siguruar cfarëdo teknologji. Prandaj sigurohuni që të gjitha pajisjet e shtëpisë (duke përfshirë pajisjet mobile) dhe aplikacionet janë të arnuara plotësisht. Mënyra më e thjeshtë për ta bërë këtë është aktivizimi i funksionit automatik të arnimit të sigurisë.
- **Anti-Virus:** Njerëzit bëjnë gabime, dhe ne nganjëherë pa dashje shtypim një link apo instalojmë dicka që nuk do të duhej. Përderisa antivirusi nuk mund të ndalë cdo aplikacion të dëmshëm, mund të ndihmojnë në ndaljen e sulmeve më të zakonshme. Prandaj sigurohuni që të gjithë kompjuterët në shtëpinë tuaj kanë antivirus dhe që përditësohet me rregull.
- **Fjalëkalimet (ang. Passwords):** Fjalëkalimet e forta janë çelësi i mbrojtjes së pajisjeve po edhe llogarive tuaja online. Ndihmoni familjarët tuaj të krijojnë fjalëkalime të forta. Pasfrazat (ang. Passphrase) mund të jenë edhe më të lehta për t'u krijuar dhe për t'u mbajtur mend. Një ide tjetër është të instaloni një menaxhues fjalëkalimesh dhe t'i ndihmoni ata t'i ruajnë të gjithë fjalëkalimet aty në një vend të sigurt ku vetëm ata mund t'i qasen. Për llogarite kritike online mund të aktivizoni edhe shërbimin e verifikimit në dy hapa.
- **Bekapet apo kopjet rezervë:** Kur cdo gjë tjetër dështon, atëherë kopjet rezervë ju shpëtojnë. Sigurohuni që familjarët tuaj kanë një sistem të thjeshtë dhe të besueshëm të krijimit të kopjeve rezervë.



Gjeneratat e vjetra mund të kenë nevojë për ndihmën tuaj për të mbrojtur teknologjinë që përdoret në shtëpi dhe të krijojnë një ambient të sigurt për fëmijët që i vizitojnë ata.

Është mirë të bëni kontrolle mujore apo kuartale që të siguroheni që këto hapa janë të vendosur. Ne rastin më të keq të mundshëm instaloni një aplikacion për qasje në distancë në pajisjet tuaja, por sigurohuni që është i mbrojtur me enkriptim dhe fjalëkalim të fortë.

Fëmijët vizitorë

Shumë shpesh kur fëmijët vizitojnë një shtëpi të një të afërmi, rregullat që keni në shtëpi nuk vlejné më atje. Kjo nënkupton edhe rregullat për mbrojtjen e fëmijëve gjatë përdorimit të teknologjisë online. Ja disa hapa që mund të ndërmerren në këto raste.

Mbrojtja e zbrazëtirës kibernetike të gjeneratave

- **Rregullat.** Sqaroni me të afërmit tuaj rregullat dhe pritshmëritë tuaja sa i përket sigurisë së fëmijëve tuaj. Për shembull, a ka rregulla se sa gjatë mund të luajnë fëmijët online, apo kur mund t'i qasen pajisjeve mobile? Besoni që nuk është realiste të presim që fëmijët i spjegojnë rregullat gjyshërve apo të afërmeve tuaj. Një ide është të krijohet një listë e rregullave dhe t'i ndani ato me të afërmit që vizitohen nga fëmijët tuaj.
- **Kontrolli:** Nëse fëmijët tuaj e kuptojnë teknologjinë më mirë se kujdestarët e tyre ata mund ta keqpërdorin këtë. Për shembull, fëmijët mund të kërkojnë të drejtat e administratorit në kompjuterin e gjyshërve të tyre dhe pastaj mund të bëjnë çfarë të duan me të, si p.sh. të instalojnë lojëra që ju nuk do donit që ata të luajnë. Sqaroni të afërmeve tuaj që nuk mund t'i japin të drejta shtesë fëmijëve tuaj, më shumë se është e nevojshme.

Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyes e profesioniste e gjuhës angleze në OSBE.

Burimet

Inxhinjeria sociale:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#november2014
Mbrojtja e rrjetit të shtëpisë suaj:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#january2014
Pasfrazat:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2015#april2015
Anti-Virusi:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2014#december2014
Mbrojtja e fëmijëve tuaj online:	http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#april2013
Mashtrimi me anë të thirrjeve nga teknikët online:	http://www.onguardonline.gov/articles/0346-tech-support-scams
Krijimi i një posteri për siguri kibernetike në shtëpi:	http://www.securingthehuman.org/resources/posters

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në ouch@securingthehuman.org.

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



securingthehuman.org/blog



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpl](https://www.securingthehuman.org/gpl)